

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE**  
**"NoziPay" SHPK**

**TITULLI I**

**Themelimi, emërtimi, objekti, kohëzgjatja dhe selia**

**Neni 1: Data e themelimit, emërtimi dhe themeluesit**

(1) Sot, më 01/10/2023, ne themeluesit kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin:

**"NoziPay" SH.P.K.**

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Z.Evarist Rajdho**, i biri i Oresti-t, i datëlindjes 27/08/1989, lindur në Rrogazhinë, shtetas shqiptar, banues në adresën: Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtese e leternjoftimit elektronik me nr. Personal I908270570.

- **Znj.Esmeralda Vrenozj**, e bija e Gëzim-it, e datëlindjes 12/07/1990, lindur në Fier, shtetas shqiptar, banues në adresën: Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtese e leternjoftimit elektronik me nr. Personal J05712107B.

**Neni 2: Objekti**

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "NoziPay" Sh.p.k., do të ketë për objekt aktivitetin, si më poshtë:

Ofrimin, ne çfaredo lloj forme, të shërbimeve administrative dhe manaxheriale për llogari të treta duke përfshirë, por pa u kufizuar në administrimin, bashkërendimin dhe drejtimin e shoqërive të treta. Ofrimin dhe bashkërendimin e shërbimeve të marketingut (duke përfshirë studimet e tregut), të planifikimit financiar, kontabel dhe strategjik dhe informatik dhe elektronik dhe për të tretet. Veprimtari të shitjes online të mallrave dhe shërbimeve, marketplace. Veprimtaria e agjentit në tregun e sigurimeve. Web Design, Shërbime SAS (Software as a Service) Shërbime marketingu dhe promovimi, konsulence ne

menaxhimin e projekteve, agjent promocioni. Ofrim konsulence dhe raportime periodike ne lidhje me problematikat teknike, pagesat e faturave, asistencat e ndryshme dhe sherbime online. Konsulenca, agjensi rekrutimi. Sherbime ne fushen e Blockchain dhe kriptografise dhe cdo gje qe ka lidhje te drejtperdrejte apo jo te drejtperdrejte me teknologjine blockchain, krijimi, auditimi etj. Ndertim programesh kompjuterike (software) per te gjitha platomat, perfshire dhe mobile. Aktivitet në fushën e konsulencës financiare, fiskale dhe manaxheriale. Ngritja, permiresimi dhe strukturimi i shoqerive operuese në industri të ndryshme. Ngritja, permiresimi dhe mirembajtja e sistemeve kontabel dhe te kontrollit te brendeshem te njesive ekonomike si dhe trajnimin profesional te personelit qe eshte ngarkuar me funksionimin e ketyre sistemeve. Pergatitja e raporteve periodike financiare sipas nevojave te drejtuesve te biznesit. Ne pergjithesi, shoqeria mund te kryeje cdo veprimtari te nevojshme e te dobishme, te lejuar nga ligji per realizimin e objektit te aktivitetit te saj.

**Neni 3: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike e Shoqërisë Tregtare "NoziPay" Sh.p.k. është e pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo moment, sipas vendimeve të marra nga asambleja e përgjithshme e ortakëve.

**Neni 4: Selia, hapësira në internet dhe adresa elektronike**

Selia e Shoqërisë Tregtare "NoziPay" shpk është në Tiranë, në adresën: **Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Frang Bardhi, Godina Kristal Center , Hyrja nr. 33, Nr.Pasurie 6/380-N4, Zona Kadastrale Nr.8260.**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj. Për këtë, ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjenci në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

## TITULLI II

### Kapitali

**Neni 5: Shuma dhe pagesat e kapitalit themeltar**

- (1) Kapitali themeltar i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar "NoziPay" shpk, është 100,000 (Njeqind mijë)Lekë. Kapitali themeltar i Shoqërie dhe është i përbërë nga 2 (kuota) kapitali, me 2 (Dy) pjesë me vlerë pergjithshme 100,000 (Njeqind mijë)Lekë.
- (2) Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

**Ortakët Themelues:** Z.Evarist Rajdho, zotëron 1 (Një) kuotë, me 1 (Nje) pjesë me me vlerë pergjithshme 49,000 (dyzetë e nëntë mijë) Lekë që perben 49 % të kapitalit.



Zni. Esmeralda Vrenozi, zotëron 1 (Një) kuotë, me 1 (Nje) pjese me me vlerë përgjithshme 51,000 (pesedhjetë e një mijë) Lekë që perben 51 % të kapitalit.

(3) Kontributet e mësipëme janë shlyer tërësisht.

#### **Neni 6: Kërkesa për të paguar kuotat e kapitalit dhe tërheqja e kuotave të papaguara**

- (1) Administratorët mund t'i kërkojnë ortakut/ve të shoqërisë të paguajnë kontributin e papaguar në lidhje me kuotat e tij dhe çdo ortak, në varësi të marrjes së një njoftimi prej të paktën, tridhjetë ditësh të plota, që përcakton kohën dhe vendin se ku duhet të bëhet pagesa, i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e veta, si përcaktohet në njoftim. Thirrja për pagesë mund të kërkojë që pagesa të bëhet me këste. Personi të cilit i drejtohet thirrja për pagesën e kontributit përgjigjet për thirrjet që i bëhen pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së kuotave, me të cilat lidhet thirrja për pagesë.
- (2) Zotëuesit e përbashkët të një kuote mbajnë përgjegjësi bashkarisht dhe veçmas për të shlyer të gjitha thirrjet për pagesë të kontributit, të cilat lidhen me këtë kuotë.
- (3) Nëse një thirrje për pagesë mbetet e pashlyer në fund të afatit të vet, personi të cilit i drejtohet thirrja dhe i cili është përgjegjës për pagesën, paguan një interes mbi shumën e papaguar, duke filluar nga dita kur mbaron afati deri në momentin e pagimit me një normë vjetore interesi sipas bankës së shtetit.
- (4) Nëse një thirrje për pagesë mbetet e papaguar pas mbarimit të afatit, Administratorët mund t'i japin një njoftim prej jo më pak se katërbëdhjetë ditësh të plota personit që është përgjegjës për pagesën, përmes të cilit i kërkojnë të paguajë shumën e papaguar së bashku me interesin që mund të jetë akumuluar. Në njoftim jepet emri i vendit ku duhet bërë pagesa dhe në të deklarohet se nëse nuk zbatohet, kuotat e pronësisë me të cilat lidhet njoftimi, përgjigjen duke u anuluar.
- (5) Nëse njoftimi nuk zbatohet, kuota me të cilën lidhet njoftimi, përpara se të bëhet pagesa e kërkuar nga njoftimi, mund të tërhiqet me vendim të administratorëve dhe tërheqja përfshin edhe të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me aksionet e tërhequra dhe të papaguara deri në momentin e tërheqjes.
- (6) Në varësi të parashikimeve të Ligjit, një kuotë e tërhequr mund të shitet, të rishpërndahet ose të hiqet në bazë të kushteve dhe mënyrës që konsiderojnë të arsyeshme administratorët.
- (7) Personi prej të cilit janë tërhequr kuotat e kapitalit, pushon së qeni ortak në lidhje me kuotat e tërhequra, por vazhdon të jetë përgjegjës përpara shoqërisë, për të gjitha kontributet të cilat janë të pashlyera në datën e tërheqjes së kuotave në lidhje me këto kuota, së bashku me interesin e llogaritur me normën e interesit të zbatueshëm për këto kontribute përpara tërheqjes.

#### **Neni 7: Llojet e kuotave, të drejtat dhe kufizimet**

Në përputhje me dispozitat të Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, çdo kuotë mund të emetohet me të drejta ose kufizime të tilla, siç përcaktohet në vendimin e kualifikuar (me tri të katërtat e votës) të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me parashikimet e Nenit 87.

#### **Neni 8: Çertifikatat e kuotave të kapitalit**

Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një çertifikatë

për të gjitha kuotat që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat në zotërim të përbashkët të disa personave dhe dhënia e certifikatës përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët sipas Nenit 72 paragrafi (2) të Ligjit përbën një dhënie të mjaftueshme për të gjithë këta zotërues. Emrat e zotëruesve të përbashkët, renditen në certifikatën e kuotës. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

**Neni 9: Mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave**

Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: a) kontributit në kapitalin e shoqërisë, b) shitblerjes, c) trashëgimisë, d) dhurimit, dh) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj, por në çdo rast e kushtëzuar nga miratimi paraprak prej asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

**Neni 10: Kalimi i kuotave me kontratë**

- (1) Kontrata e kalimit të kuotës, bëhet me kontratë me shkrim dhe në bazë të formaliteteve të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakëve. Kalimi i kuotës i njoftohet selisë së regjistruar të shoqërisë.
- (2) Administratorët mund të mos pranojnë ta regjistrojnë kalimin e kuotës pranë QKB-së, nëse kuota nuk është shlyer tërësisht ose nëse nuk janë dakord që kuotën ta marrë marrësi.
- (3) Nëse Administratorët nuk pranojnë ta regjistrojnë kalimin e kuotës, ata, brenda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqëri, i dërgojnë marrësit njoftimin për mospranimin.

**Neni 11: Kalimi përmes trashëgimisë ose falimentit**

- (1) Nëse një ortak vdes, bashkëzotëruesit e mbetur gjallë dhe, në rastin kur është zotërues i vetëm ose një bashkëzotërues i vetëm i mbetur gjallë, trashëgimtarët e tij janë të vetmit persona të cilët shoqëria i njeh si titullarë të kuotës së tij, por, asnjë dispozitë e këtushme nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur, nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkarisht.
- (2) Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, mundet që, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga administratorët, të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotërues vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos, që të kërkojë, që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës tek ky person tjetër.
- (3) Personi, që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, gëzon të drejtat titullar i të cilave do të kishte qenë si zotërues i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë QKB-së, ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në asamblenë e shoqërisë.

**Neni 12: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- (1) Asambleja e Përgjithshme mund ta zmadhojë kapitalin, me vendim të kualifikuar, duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues me shumat që përcaktohen në vendimin e marrë prej saj. I njëjti vendim i kualifikuar kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

- (2) Me anë të një vendimi të marrë me një shumicë të kualifikuar të votave të asamblesë së përgjithshme, shoqëria mund të vendosë të zvogëlojë kapitalin e vet.

**Neni 13: Blerja e kuotave nga ortakët dhe të tjerët**

- (1) Ortakët e shoqërisë, kanë përparësi për blerjen e pjesës që shitet përpara personave të tretë jashtë shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim asamblesë, duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i njëjtë me atë që do t'i ofrohet edhe një personi të tretë jashtë shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit. Ortaku jep ofertën brenda 60 ditëve nga data e njoftimit dhe duhet t'u transmetojë ortakëve të tjerë këtë kërkesë dhe ortakët e tjerë duhet të japin një përgjigje brenda 60 ditëve. Edhe e drejta e përparësisë, duhet t'u jepet me shkrim duke iu drejtuar asamblesë.
- (2) E drejta e përparësisë është proporcionale me kuotat e secilit prej ortakëve, por nëse një ortak nuk është i interesuar, tjetri mund t'i blejë kuotat që shiten.
- (3) E drejta e përparësisë është në proporcion me kuotat e secilit prej ortakëve. Asambleja pasi ka kaluar afati prej 60 ditëve, brenda 30 ditëve i komunikon ortakut që shet kuotat e tij, vendimin e ortakëve të tjerë për të blerë të gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Në rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë këto kuota brenda 60 ditëve i ofrohen personave të tretë jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave, duhet të bëhet me akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e ortakëve.

**TITULLI III**


**Asambleja e Përgjithshme**

**Neni 14: Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

- (1) Administratorët mund të thërrasin mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, kur ta mendojnë të arsyeshme vetë dhe duhet ta thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme sa herë ta kërkojnë ortakët në përputhje me Nenin 84 të Ligjit.
- (2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me anë të një letre ose një mesazhi me postë elektronike, që i drejtohet secilit prej ortakëve, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të bëhet të paktën shtatë ditë të plota pune përpara datës së mbledhjes. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe PIN-i për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin në mbledhje.
- (3) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur në përputhje me parashikimet e pikës 1 dhe 2 të këtij neni, kjo periudhë mund të jetë edhe më e shkurtër, dhe asambleja mund të marrë vendime të vlefshme, nëse këtë e aprovojnë të gjithë ortakët që zotërojnë 100%(njëqind përqind) të vlerës nominale të kuotave të kapitalit të shoqërisë, janë dakord, për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.

**Neni 15: Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

- (1) Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, nuk mund të fillojnë nëse nuk është i pranishëm kuorumi i parashikuar në Nenin 86 të Ligjit. Ortakët ose zotëruesit e prokurave të votimit mund të jenë të pranishëm përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video, sipas Nenit 88. Ortakët që marrin pjesë përmes mjeteve elektronike kanë të drejtë të votojnë pasi të paraqesin PIN-in që u është dhënë së bashku me



- njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- (2) Administratorët caktojnë një Kryetar për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes së saj.
  - (3) Nëse asnjëri prej Administratorëve nuk ka dëshirë të jetë Kryetari i mbledhjes ose nëse asnjëri prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta, duke filluar nga ora e vendosur për të mbajtur mbledhjen, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre për të drejtuar mbledhjen si Kryetar i saj.
  - (4) Pavarësisht nëse është apo jo ortak, Administratorit i lejohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.
  - (5) Me pëlqimin e mbledhjes në të cilën është i pranishëm kuorumi, Kryetari mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon asambleja), t'i shtyjë punimet e Asamblesë, por në një mbledhje të shtyrë të Asamblesë nuk mund të diskutohet asnjë pikë me përjashtim të pikave të cilat mund të ishin zgjidhur rregullisht nëse nuk do të ishin ndërprerë dhe shtyrë punimet e Asamblesë. Kur punimet e Asamblesë janë shtyrë për katërmbëdhjetë ditë ose më shumë, duhet dhënë një njoftim prej të paktën shtatë ditësh të plota në të cilin përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe natyra e përgjithshme e pikave të punës që duhen kryer. Përndryshe, asnjë njoftim i tillë nuk do të ishte i nevojshëm.
  - (6) Vendimet që duhen aprovuar përmes votimit të Asamblesë merren me votë të hapur, nëse, përpara ose gjatë deklarimit të rezultatisht, nuk është kërkuar në mënyrë të rregullt një votim i fshehtë. Votimin e fshehtë mund ta kërkojë
    1. Kryetari; ose
    2. një ortak ose disa ortakë që përfaqësojnë jo më pak se pesë përqind të votave gjithsej të asamblesë së shoqërisë.Kërkesa e bërë nga një person që ka prokurë votimi nga një ortak, ka të njëjtën vlerë sikur ta bëjë ortaku në fjalë.
  - (7) Nëse nuk kundërshtohet nga një ortak, deklarata nga ana e Kryetarit se një vendim është miratuar në mënyrë unanime ose me një shumicë të caktuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi i këtij fakti në procesverbalin e takimit është informacion i formës së prerë i faktit, pa pasur nevojë për provën e numrit apo përqindjes së votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
  - (8) Nëse ka kundërshtime për këtë deklaratë, atëherë zhvillohet një votim i fshehtë për të përcaktuar numrin e votave të hedhura pro dhe kundër vendimit.

#### **Neni 16:           Votat e ortakëve**

- (1) Në varësi të të drejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, secila kuotë e një ortaku i cili (si individ) është i pranishëm vetë ose përmes një prokure përfaqësimi ose (si shoqëri) është i pranishëm përmes përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt ose përmes një prokure përfaqësimi, ka të drejtën e një vote.
- (2) Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose përmes një prokure përfaqësimi, në lidhje me kuotat që zotëron vetë, nëse nuk janë paguar tërësisht kontributet nga ana e tij në lidhje me kuotën në fjalë.
- (3) Kundërshtimet e ngritura për plotësimin e kushteve nga ana e një votuesi i bëhen në kohë Kryetarit, vendimi i të cilit është i formës së prerë. Të gjitha votat e pahequra në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë janë të vlefshme.
- (4) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asamblea e përgjithshme merr në shqyrtim çështjet për:
  - a. Vlerësimin e veprimtarisë së tij,
  - b. Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij,
  - c. Dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si



dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

**Neni 17: Hetimet e posaçme**

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një audituesi të posaçëm sipas Nenit 91, të Ligjit e bëjnë një kërkesë të tillë përmes depozitimit në selinë e shoqërisë të një dokumenti së bashku me një deklaratë noteriale, e cila vërteton se personi ose personat i plotësojnë kushtet për këtë veprim.

**TITULLI IV  
Administratorët**

**Neni 18 : Emërimi i administratorëve**

(1) Asambleja e përgjithshme emëron si administratorë të shoqërisë me afat 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje personat e mëposhtëm:

Të dhënat e identifikimit:

(mbiemri, emri, adresa):

Rajdho, Evarist, Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Tiranë.

(2) Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorëve parashikohen në Nenin 95, paragrafi (2) të Ligjit.

**Neni 19: Kompetencat e Administratorëve**


- (1) Veprimtaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga Administratorët, të cilët mund t'i ushtrojnë të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme nga Neni 81 i Ligjit (6). Asnjë ndryshim i Statutit dhe asnjë direktivë nga ana e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund t'i bëjë të pavlefshme veprimet e mëparshme të Administratorëve, të cilat do të kishin qenë të vlefshme nëse nuk do të ishte bërë ndryshimi apo nëse nuk do të ishin dhënë direktiva.
- (2) Administratori ka këto të drejta dhe detyrime:
  - a. Administratori i shoqërisë ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b. Administratori i shoqërisë ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c. Administratori i shoqërisë ka për detyrë të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë,
  - d. Administratori i shoqërisë ka për detyrë të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim.
  - e. Administratori i shoqërisë ka për detyrë të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.

- f. Administratori i shoqërisë ka për detyrë të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
  - g. Administratori i shoqërisë ka për detyrë të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
  - h. Administratori i shoqërisë mund të nënshkruajë dhe mund të ndërmarrë çdo lloj veprimi ose operacioni shitblerjeje normale (të punës).
  - i. Administratori i shoqërisë ka të drejtë të nënshkruajë çdo lloj huaje, kredi, discaunts dhe çdo ofrim fondesh, që përbën një kredi për shoqërinë.
  - j. Administratori i shoqërisë ka të drejtë të nënshkruajë çdo lloj akti ligjor, kontrate, marrëveshje, deklarate të çdo lloji që do të ketë lidhje me asetet e shoqërisë.
  - k. Administratori i shoqërisë, për të hyrë në transaksione, ka të drejtë të nënshkruajë çdo lloj akti ligjor apo për të ekzekutuar ndonjë akt, që përfshin pasuri të luajtshme apo të paluajtshme të Shoqërisë, pavarësisht nga vlera e transaksionit apo e aktit.
- (3) Administratorët mund t'ua delegojnë kompetencat e tyre komiteteve që përbëhen nga një ose më shumë administratorë. Një delegim i tillë mund të bëhet në varësi të kushteve që mund të vendosin Administratorët dhe mund të revokohet ose të ndryshohet.
- (4) Bazuar në nenin 96, të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", administratorët kanë këto kufizime në të drejtat e veprimit për çështjet e mëposhtme:
- a. Administratori i shoqërisë nuk mund të nënshkruajë dhe ndërmarrë asnjë lloj veprimi ose operacioni blerje normale (të punës) që i kalon vlerën në shumën limit prej Lek 500'000(pesëqind mijë), në një muaj kalendarik.
  - b. Administratori i shoqërisë nuk ka të drejtë të nënshkruajë asnjë lloj huaje, kredie, discaunts dhe çdo ofrim fondesh, që përbën një kredi për shoqërinë, pa miratimin e asamblesë së përgjithshme.
  - c. Administratori i shoqërisë për çdo transaksion bankar mbi shumën limit prej Lek 500'000(pesëqind mijë), do të shqyrtohet dhe miratohet me gjithnjë me kundërfirmën e personit të autorizuar nga asambleja e ortakëve.
  - d. Administratori i shoqërisë nuk ka të drejtë të nënshkruajë asnjë lloj akti ligjor, kontrate, marrëveshjeje, deklarate të çdo lloji që do të ketë lidhje me asetet e shoqërisë. Për çdo lloj akti ligjor, që do të ketë lidhje me asetet e shoqërisë, administratori i shoqërisë do të veprojë vetëm në bazë të një Vendimi të asamblesë së ortakëve të shoqërisë.
  - e. Administratori i shoqërisë, nuk ka të drejtë për të hyrë në transaksione, të nënshkruajë asnjë lloj akti ligjor apo për të ekzekutuar ndonjë akt, që përfshin pasuri të luajtshme apo të paluajtshme të Shoqërisë, pavarësisht nga vlera e transaksionit apo e aktit.
  - f. Administratori i shoqërisë nuk ka të drejtë për të ndarë, tjetërsuar apo për të transferuar asnjë aset, pasuri apo biznes të shoqërisë.
  - g. Administratori i shoqërisë nuk ka të drejtë për çdo operacion, transaksion, kërkesë, aplikim dhe/ose aktivitet tjetër, që lidhet në përgjithësi për markat e të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale të shoqërisë.
  - h. Për të blerë kuota/aksione apo pjesë kapitali në shoqëri të tjera.
- (5) Administratorët nuk mund të delegojnë asnjërin prej detyrimeve të cilat ua ngarkon ligji.

**Neni 20: Skualifikimi dhe largimi i administratorëve**

(1) Posti i Administratorit lirohet nëse:

1. pushon së qeni Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit, përfshirë Nenin 95, paragrafi (6).



2. hyn në procedurën e paafësisë pague;e;
3. vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën shoqërisë; ose
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Administratorëve të tjerë, në mbledhjet e administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe ose Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Administratorëve të tjerë vendos ta lirojë nga detyra.

**Neni 21: Shpërblimi i punës, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorëve**

- (1) Administratorët kanë të drejtë të marrin shpërblim për punën e tyre, sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë në përputhje me Nenin 97 të Ligjit.
- (2) Asambleja e Përgjithshme mund të japë përfitime, në të holla, pensione, sigurime ose forma të tjera, për ata persona të cilët kanë punuar më parë për shoqërinë ose për shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë filiale të shoqërisë ose për shoqëri pararendëse të shoqërisë ekzistuese, ose për familiarë të tyre (përfshirë bashkëshortin, bashkëshorten, ish-bashkëshortin ose ish-bashkëshorten) ose për persona të cilët janë në varësi të tyre, dhe mund të japë kontribute në fonde të caktuara për dhënie e përfitimeve të tilla (si përpara ashtu dhe pasi personi në fjalë pushon së mbajturi postin ose marrëdhënien e punës).
- (3) Administratorëve u paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit apo të tjera që u lindin në lidhje me pjesëmarrjen në mbledhjen e Administratorëve apo të komiteteve të Administratorëve ose në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme apo mbledhje të veçanta të zotëruesve të klasave të aksioneve të shoqërisë, si dhe shpenzimet që lidhen me kryerjen e detyrave të tyre.

**Neni 22: Punimet e Mbledhjeve të Administratorëve**

- (1) Mbledhjet e Administratorëve mbahen sa herë ta kërkojë aktiviteti i shoqërisë.
- (2) Kuorumi i nevojshëm për të filluar punimet, mbledhja e Administratorëve, mund të vendoset prej tyre dhe, nëse nuk vendoset prej tyre, atëherë ky kuorum është dy.
- (3) Asambleja e Përgjithshme ngarkon njërin prej Administratorëve me detyrën e Kryetarit të mbledhjeve të Administratorëve, duke ruajtur të drejtën për ta shkarkuar nga kjo detyrë në çdo kohë. Kryetari drejton punimet e çdo mbledhjeje të Administratorëve në të cilat është i pranishëm. Por, nëse Kryetari nuk ka dëshirë të drejtojë punimet e mbledhjes ose nëse nuk është i pranishëm për pesë minuta duke filluar nga ora e caktuar për mbledhjen, Administratorët e pranishëm mund të caktojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- (4) Vendimet për çështjet që lindin në një mbledhje merren me shumicë votash. Nëse numri i votave është i barabartë, Kryetari ka të drejtën e hedhjes në një votë të dytë.
- (5) Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratorëve ose nga një komitet i Administratorëve, ose nga një person që ushtron detyrën e Administratorit, pavarësisht faktit nëse më vonë zbulohet se ka pasur mangësi në emërimin e ndonjërit prej Administratorëve ose se njëri prej tyre ka qenë i skualifikuar nga e drejta për të mbajtur detyrën ose nuk ka pasur të drejtë vote, janë të vlefshëm njësoj sikur të gjithë këta persona të ishin emëruar rregullisht, të plotësonin kushtet, të vazhdonin të ishin Administratorë dhe të kishin të drejtën e votës.
- (6) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë Administratorët të cilët kanë të drejtë të njoftohen për një mbledhje të Administratorëve ose të një komiteti të Administratorëve ka vlerë dhe fuqi njësoj sikur të ishte miratuar në mbledhjen e

Administratorëve ose të komitetit të Administratorëve të mbledhur dhe të zhvilluar rregullisht.

**Neni 23: Kufizimet per votimin**

- (1) Një Administrator nuk lidh asnjë marrëveshje dhe nuk voton në një mbledhje të Administratorëve për asnjë vendim që ka lidhje me një çështje në të cilën ka, drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, një interes ose detyrë me rëndësi materiale dhe që bie ose mund të bjerë ndesh me interesat e shoqërisë, sipas nenit 13 të Ligjit, nëse të gjithë anëtarët e një mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme nuk kanë rënë dakord:
  1. të autorizojnë lidhjen e marrëveshjes nga ana e tij dhe,
  2. ta autorizojnë të votojë për çështjen në fjalë.Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të veçantë. Çdo aprovim i përgjithshëm, duhet të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- (2) Një Administrator nuk konsiderohet si pjesëtar i kuorumit të pranishëm në një mbledhje në lidhje me një vendim për të cilin nuk ka të drejtë vote. Për përjashtimin e Administratorit nga marrja e vendimit në një mbledhje të tillë, zakonisht, zbatohet përkatësisht Neni 89 i Ligjit.
- (3) Nëse në një mbledhje të Administratorëve lind një çështje për sa i takon të drejtës së një Administratori për të votuar, çështja mund t'i kalohet, para mbylljes së mbledhjes, Kryetarit të mbledhjes, vendimi i të cilit për të gjithë Administratorët me përjashtim të vetes së tij konsiderohet i formës së prerë.

**Neni 24: Procesverbalet e Mbledhjeve të Administratorëve**

Administratorët kujdesen që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet:

1. e të gjitha takimeve të bëra nga Administratorët dhe,
2. të të gjitha punimeve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe mbledhjeve të Administratorëve dhe të komiteteve të Administratorëve, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në këtë mbledhje.

**KAPITULLI V**

**Dividentet dhe kapitalizimi i fitimeve**

**Neni 25: Dividentet**

- (1) Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të shpallë dividente në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- (2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividentet deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumat e paguara për kuotat në lidhje me të cilat paguhet dividenti. Të gjithë dividentet përpjesëtohen dhe paguhet në përpjestim me shumat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividenti. Por, nëse kuotat emetohen me kushtin se merr dividend, duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë kuota në fjalë e merr dividendin sipas këtij kushti.
- (3) Asnjë dividend dhe asnjë mjet monetar i pagueshëm në lidhje me një kuotë, nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria nëse një gjë



- e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës.
- (4) Nëse një dividend nuk është tërhequr pas dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të tërhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është e detyruar ta paguajë.

**Neni 26: Kapitalizimi i fitimeve**

Me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe duke pasur në konsideratë parimet e vendosura nga Neni 14 i Ligjit, Administratorët mund të vendosin të kapitalizojnë fitimet e pashpërndara të shoqërisë, që nuk kërkohen për të paguar dividendë preferenciale ose borxhe të tjera të pashlyera ende nga shoqëria dhe kapitali i detyruar i shoqërisë.

**TITULLI IV  
Prishja dhe Njoftimet**

**Neni 27: Prishja dhe Likuidimi**

- (1) Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:
- me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
  - me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
  - me vendim të gjykatës;
  - për arsye të tjera, të parashikuara në statut.
- (2) Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesit me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund t'i shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.
- (3) Administratorët regjistrojnë prishjen/likuidimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Nëse prishja/likuidimi i shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim.

**Neni 28: Njoftimet**

- (1) Njoftimet që i jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit, duhet të jenë me shkrim ose përmes komunikimit elektronik në adresën e parashikuar në Nenin 4, paragrafi (8) i këtij statuti, që është i vlefshëm në momentin që i bëhet e ditur për këtë qëllim personit që bëri njoftimin.



- (2) Shoqëria mund t'i japë një njoftim një ortakut ose personalisht ose duke ia nisur me postë në një zarf, për të cilin është paguar edhe kthimi i përgjigjes në adresën e regjistruar të ortakut ose duke ia lënë në këtë adresë ose duke ia dhënë përmes komunikimit elektronik në adresën që është e vlefshme për momentin dhe i është bërë e ditur shoqërisë nga ana e ortakut. Kur ka bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve në përputhje me Nenin 72, paragrafi (2) i Ligjit.
- (3) Në këtë Statut përfshihen shtesa dhe ndryshime dhe të gjitha dokumentat e tjera, raportet, komunikatat dhe procesverbalet e shoqërisë, vendosen nga Administratorët në hapësirën në internet të shoqërisë të parashikuar në Nenin 4, paragrafi (2) i këtij Statuti.

**Neni 29: Dispozita të përgjithshme**

Përsa i përket çështjeve që nuk janë parashikuar nga ky statut, do të aplikohen dispozitat e Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar sipas Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Selia e shoqërisë duhet të ketë të mbishkruar pas kësaj të paktën emrin e shoqërisë, numrin e vendimit dhe vitin e inkomporimit dhe fjalët "Vula e shoqërisë".

Çdo mosmarrëveshje që del nga kjo marrëveshje do të caktohet para gjykatës së vendit, ku ndodhet zyra e regjistruar e shoqërisë.


**Neni 30: Dispozita përfundimtare**

Ky Statut përpilohet në 5(pesë) kopje origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe. Statuti mbyllet me 29 (njëzet e nëntë) nene. Ky statut do të hyjë në fuqi menjëherë me regjistrimin e tij në QKB.

Lexuar, miratuar dhe nënshkruar.

**Emrat dhe Nënshkrimet e Ortakëve Themelues të :  
Shoqërisë Tregtare "NoziPay" SH.P.K.**

**Esmeralda Vrenosi**



**Evarist Rajdho**

